

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA: Masat e reja ekonomike ndaj Iranit janë të suksesshme - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/shba-masat-e-reja-ekonomike-ndaj-iranit-jane-te-suksesshme/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 09:26:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 09:21:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	834dd1339e5a21b72bd4a2e587bb2df6e39dd8604d1404e457fbc4a3ca734641
TEKSTI	8eae92a2b18271380d6a1ad446656c864f6787299f327998bf51bb1a248533ab
PAMJA	5cbd96a0e4da0de9068f8dd7704c3ff584ce2bd1d4f3c0fe95acbfa14f83ed2c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f19d759c3cbfc33803386cb9801c7cc3c322caf52dd48e76e98cdabf35335a1d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	48d5adc2dc979f83a887c219539e18c9885fc52000dc610804adb08caf975432
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f19d759c3cbfc33803386cb9801c7cc3c322caf52dd48e76e98cdabf35335a1d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Shqipëri-Bjellorusi SHBA Donald Trump Sergey Lavrov Pakistan

BOTA

SHBA: Masat e reja ekonomike ndaj Iranit janë të suksesshme

27 Shtator 2026 | 11:21

Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, tha se ka dërguar përfaqësues në mbarë botën për t'iu bërë presion vendeve që ta izolojnë ekonomikisht Iranin, duke përmendur kufizime të reja që kanë goditur linjat ajrore të Republikës Islamike dhe sektorët bankarë.

"Me udhëzimin tim, ekipet janë dislokuar në mbarë globin për t'u angazhuar me shtetet dhe për të kërkuar veprim kundër regjimit iranian", shkroi ai në X.

"Këto përpjekje po japin rezultate", shtoi sekretari Bessent.

Bessent tha se Emiratet e Bashkuara Arabe kanë ndaluar të gjitha fluturimet e kompanive ajrore iraniane dhe se Turqia dhe Omani kanë ndaluar fluturimet hyrëse të Mahan Air.

Emirati i Dubait në Emiratet e Bashkuara Arabe është një destinacion i rëndësishëm për kompanitë ajrore iraniane, me disa fluturime në ditë, si dhe atje ka një komunitet të madh iranian.

Një artikull i Wall Street Journal, të cilin e shpërndau Bessent, tha se ndihmësekretrari i Thesarit për financimin e terrorizmit ka udhëtuar nëpër Lindjen e Mesme dhe Evropë për dy javë për të shtyrë përpara planin për vendosjen e asaj që Bessent e quajti "Dita D ekonomike" ndaj Iranit.

Sipas kësaj media amerikane, janë zhvilluar diskutime me më shumë se 50 vende.

Së voni, Shtetet e Bashkuara kanë nisur një "ofensivë ekonomike" ndaj Iranit, që synon ndërprerjen e çdo burimi ekonomik të regjimit. Bessnet ka thënë në gusht se masat synojnë izolimin e Republikës Islamike.

Masat amerikane vijnë në kohën kur SHBA-ja dhe Irani ende nuk kanë arritur një marrëveshje për përfundimin e luftës që nisi në fund të shkurtit.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka deklaruar se beson që një marrëveshje për përfundimin e konfliktit do të arrihet pas zgjedhjeve të mesmandatit që mbahen në SHBA në nëntor.

LAJMI I FUNDIT

11:09 U arrestua nga SPAK në Shkodër, GJKKO lë në burg Bledar Cagin

10:58 Alarm pranë bazës amerikane në Britani, arrestohen disa persona dhe evakohen banorët

10:42 Stradner: Kremlini mund ta ndihmojë Vuçiçin me energji

SHPËRNDAJE
ARTIKULLINë pritje të përgjigjes zyrtare, Irani reagon pas refuzimit të Trump

10:34 "Si në kohën e Hitlerit"! Lavrov: Gjermania s'ka zënë mend nga lufta

10:21 Nëntë të arrestuar në Zubin Potok për krime lufte, operacioni lidhet me rastin "Grupi i intelektualëve"

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Në pritje të përgjigjes zyrtare, Irani reagon pas refuzimit të Trump

Irani ka deklaruar se do të presë për një përgjigje zyrtare nga negociatorët amerikanë, pasi presidenti Donald Trump refuzoi propozimin për hapjen e ngushticës së...

10:36 | 27/09/2026

BOTA

Rrëzohet helikopteri në Kanada, humbin jetën 4 persona

Katër persona humbën jetën në një rrëzim helikopteri në juglindje të Montrealit, njoftoi policia në provincën kanadeze të Kebekut të shtunën pasdite. Sipas rrjeteve televizive...

10:14 | 27/09/2026

BOTA

Pakistan, të paktën 11 të vdekur dhe 18 të plagosur nga një sulm ndaj një pike kontrolli

Të paktën 11 persona u vranë dhe 18 të tjerë u plagosën në një shpërthim në një pikë kontrolli në Pakistanin verior sot, thanë autoritetet...

09:47 | 27/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.